

VENDIM
Nr.485, datë 16.7.2004

PËR TRANSFERIMIN E FONDEVE BUXHETORE BASHKISË SË ELBASANIT,
PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË QENDRËS SOCIALE
“BALASHE”

(Ndryshuar me VKM nr. 547, datë 12.8.2004)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 20.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004” dhe të nenit 13 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë së Elbasanit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i transferohet fondi prej *6 483 000 (gjashtë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekësh*, për mbulimin, për 6-mujorin e dytë të këtij viti, e shpenzimeve administrative të qendrës sociale “Balashe”, Elbasan.

2. Ky fond t’i pakësohet buxhetit të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, miratuar për vitin 2004.

3. Ngarkohen Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe kryetari i bashkisë së Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano